



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PRAKTIKË PROFESIONALE 2

Ngarkesa: 4 ects, 80 orë

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar "Komunikim Shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,5, 6, 7)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme: Të mundësojë që studentët të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në fushën e komunikimit shumëgjuhësh, ndërkulturor dhe organizativ. Të zhvillojë kompetencat profesionale, ndërpersonale, organizative dhe ndërkulturore të nevojshme për integrimin e suksesshëm të studentëve në tregun e punës.

Objektivat specifike

- Të aftësojë studentët të përdorin gjuhët e huaja dhe teknikat e komunikimit shumëgjuhësh në detyra konkrete profesionale, si përkthimi, redaktimi, raportimi dhe komunikimi me klientët.
- Të zhvillojë aftësitë për përgatitjen e dokumenteve profesionale, menaxhimin e detyrave dhe projekteve dhe bashkëpunimin në mjedise shumëgjuhëshe.
- Të aftësojë studentët të identifikojnë dhe analizojnë situata të vështira komunikimi, duke propozuar zgjidhje të përshtatshme profesionale dhe ndërkulturore.

Rezultatet e pritshme të të nxënit

Në përfundim të praktikës profesionale, studenti do të jetë në gjendje të zbatojë njohuritë teorike dhe gjuhësore në situata konkrete të punës, duke realizuar detyra të komunikimit shumëgjuhësh, përkthimit, redaktimit dhe komunikimit institucional. Do të demonstrojë kompetenca profesionale, organizative, ndërpersonale dhe ndërkulturore, si dhe aftësi për të bashkëpunuar në grup dhe për të menaxhuar detyra e projekte në mjedise profesionale. Gjithashtu, do të jetë në gjendje të vlerësojë dhe reflektojë mbi përvojën profesionale, duke identifikuar sfidat dhe duke propozuar zgjidhje efektive për situatat e komunikimit.